



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 23.10.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Sllavisa Trajkovic
8. Idajet Graip

Të tjerë prezent

1. Shkelzen Hajdini, DSH
2. Lidija Lovanovic ZKKK
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Përfaqësues të OSBE-së dhe UNMIK-ut

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhja e 17-te dhe 18
2. Informatë nga drejtorati për Shëndetësi për punët e deritanishme.
3. Raporti i punës së ZKKK-së.
4. Të ndryshme.

I

Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 17 dhe 18-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstrakteve nga mbledhja 17 dhe 18 -të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Pastaj Kryesuesi i komitetit tha se pasi që drejtori i shëndetësisë nuk është prezent po kalojmë ne piken e 3-te, te rendit te ditës.

III

Raporti i punës së ZKKK-së.

Lidhur me raportin e punës së ZKKK-së, ne pika të shkurta i njoftoi, Lidija Jovanovic e cila tha se ne kemi vazhduar me aktivitetet tona te përgjithshme si zyre, po ashtu tha se kemi pas marrëveshje me disa organizata për disa aktivitete për komunitetet jo shumicë. Kemi nda edhe ndihmat e një hershme për familjet në nevojë. Me organizatën joqeveritare daneze kemi arrite që ti punësojmë ne organizata private disa persona te riatdhesuar ne page prej 300 euro, ku pagesën e bënë kjo organizatë. Po ashtu është bërë furzimi i shkollës “Vëllëzrit Aksiq “ me material higjienik dhe lëndë djegëse për ngrohje.

Zoran Cirkovc, tha se e falënderoj ZKKK-në për raportin është një raport shume i mire edhe i falënderoj për punën që po e bëjnë.

Lulmturije Bytyqi-Hasani, pyeti se këta 11 përfituesit te cilit komunitet janë?

Ledija Jovanovic, Përfituesit janë te të gjitha persona të riatdhesuar.

Skender Bikliqi, tha se e falënderoj për raportin e punës ZKKK-në një raport shume i mirë.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

II

Informatë nga drejtorati për Shëndetësi për punët e deritanishme.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi , ia kaloi fjalën Shkelzen Hajdinit i cili i njoftoi te pranishmit me punët ne shëndetësi. Tha se është shtuar numri i analizave për pacientë, ky muaj ka qenë muaji rozë, luftimi i kancerit të gjirit. Kemi arrite që sensibilizojmë qytetaret për këtë sëmundje dhe vlejné te theksohet se kemi organizuar transportin falas për mamografi ne Prishtinë. Po vazhdojmë renovimin e QMF-së në Janjevë. Sfidë mbetet blerja e një mamografi për te ardhmen.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Skender Bikliqi, tha se ju falënderoj për punën që po e bëni e sidomos për punën që jeni duke e bere ne renovimin e QMF-së në Jnajeve dhe punët tjera te mira që po bëhen dhe keni lëvdata nga banoret e Janjevës.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se a janë marre parasysh propozimet tona, si propozim i imi ka qenë vaksinimi i komunitetit jo shumicë. Dhe e dyta ku është drejtor i QKMF-së? Dhe gjatë emrimit te ushtruesit te drejtorit a janë bërë shkelje ligjore.

Shkelzen Hjadini, u përgjigj se ekipi i vaksinimit 16 familje refuzuese i ka vaksinuar dhe kjo është një arritje e madhe.

Shahadije Bikliqi, pyeti se a ka mundësi që të vazhdohet dhe pas muajit rozë që të behet melografia pasi që ka interesim të madh.

Shkelzen Hjadini, tha se do ta shohim mundësinë e vazhdimit. Ndërsa drejtori është në pushim vjetor, me vendim e kemi bërë ushtruesë të detyrës doktoreshën, nuk kemi bërë shkelje ligjore.

Zoran Cirkovic, tha se sa është numri i të punësuarve nga radhët e komunitetit serb dhe malazez në QKMF dhe e ka mundësi që të shpallet një konkurs i veçantë për radhët e minoriteteve.

Shkelzen Hjadini, tha se ligjërisht nuk kemi mundësi me pas konkurs të tille, por në kushte të barabarta do të ju epim përparësi radhëve të komuniteteve

IV

Te ndryshme

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i komitetit Skënder Bikliqi, tha se vizitat të cilat i kemi realizuar në terren kanë qenë jo të suksesshme, qëllimi i tyre ishte që për se afërmi të njihmi me problemet dhe jetën në vendbanimet ku ata jetojnë. Vizita që e kemi bërë në Rubovc dhe Grackë ku jetojnë komuniteti Serb dhe Malazez, në shkollën fillore në Rubovc stafi i shkollës na dha disa informata por nuk na lejuan që ta vizitojmë shkollën me arsyetimin se paraprakisht duhet të merret leje të drejtorit të shkollës në Lipjan. Ndërsa në fshatin Grackë nga anëtarët i komitetit Zorani, morëm disa informata për jetën dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti malazez.

Zoran Cikrovic, tha se takimi të cilin e kemi caktuar në Rubovc dhe Grackë ka qenë jo i koordinuar mirë pasi që jemi shkuar pa e njoftuar drejtorin e shkollës po ashtu ka qenë situata jo e mirë dhe kjo ka ndikuar keq, pasi që dihet që në Lipjan të gjitha komunitetet kalojnë shumë mirë në mes vetë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se takimi i fundit nuk ka qenë i organizuar mirë pasi që ne jemi shkua në shkolle pa u njoftuar drejtorit të shkollës, dhe ne nuk jemi inspektor me hy në shkollë pa paralajmërim, me pengë procesin mësimor.

Shahadije Dragacina, tha se ne jemi anëtarë e komitetit dhe mundemi me shkua me vizituar çdo komunitet në terren dhe me pa si është gjendja e tyre.

Skender Bikliqi, kryesuesi i komitetit tha se ku do të jetë mësim për herët tjera dhe vizitat tjera të cilat do të realizojmë do të njoftojmë me kohë.

Lulzim Qerimi, tha se kërkoj nga anëtarët e komitetit që sa herë kanë ndonjë problem komunitetet të adresoheni direkt të unë, sepse do të jemi me efikas në zgjidhjen e problemeve të tyre.

Meqë çështje të tjera nuk pati vizita përfundoi në ora 15³⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi